



Prishtinë, 20 dhjetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1075_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja bazuar në BRE;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 par 1 dhe 4, nenin 5, nenin 6 paragrafi 1 dhe 3, neni 7, neni 11 par. 3, 4, 5, 6 dhe 7, nenin 12 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Vendimin nr. V_810_2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lepenci 2, ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, të datës 13.12.2017 nr. prot. 523/17 të shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., me adresë: Magjistralla Prishtinë – Ferizaj, fsh. Konjuh, Lipjan Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

Për Lëshimin e Autorizimit Preliminar

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI PRELIMINAR** shoqërisë "DINO ENERGY" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lepenci 2, ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "DINO ENERGY" SH.P.K., do t'i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në



pikën II. të këtij Vendimi dhe ti lëshohet Autorizimi Final në përputhje me Rregullën e Autorizimit.

- IV. Vendimi për Autorizimin Preliminar përcakton disponueshmërinë e caqeve dhe kualifikimin në skemën mbështetëse.
- V. Vendimi për Autorizimin Preliminar përcakton se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse sipas Vendimit V_810_2016 të datës 10 maj 2016, të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- VI. Vendimi për Autorizimin Preliminar përcakton se shoqëria "DINO ENERGY" SH.P.K., brenda tridhjetë (30) ditësh pune nga pranimi në Skemën Mbështetëse duhet të paguaj garancinë financiare, për projektin e Hidrocentralit HC Lepenci 2 me kapacitet 3.3 MW në përputhje me Nenin 12 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve. Pranimi në Skemën Mbështetëse do të jetë efektiv nga data e pagesës së kësaj garancie.
- VII. Vendimi për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhën dymbëdhjetë (12) mujore, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit Final për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.

Arsyetim

- ZRRE me datë 13.12.2017 nga shoqëria "DINO ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lepenci 2, ZK Kaçanik, me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, në Komunën e Kaçanikut, Republika e Kosovës.
 - ZRRE me datë 13.12.2017 nga shoqëria "DINO ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse.
 - ZRRE me datë 10.12.2018 shoqërinë "DINO ENERGY" SH.P.K., e ka njoftuar në lidhje me garancionin financiar që duhet të paguhet nga aplikuesi në mënyrë që pranimi në skemën mbështetëse të jetë efektiv dhe njëkohësisht ti garantohet tarifa nxitëse dhe marrëveshja për blerje të energjisë.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimi të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
 - IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së